



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 582/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Ramadan Gashi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Gllogoc, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa parashtruara nga Ramadan Gashi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Gllogoc, me shenjë ZL.Anr.582/2017 e datës 09.11.2017, të parashtruar kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ më datë 08.11.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017 në ora 12:00, nga Ramadan Gashi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Gllogoc, me të cilën pretendon se me rastin e publikimit të rezultateve në vendvotimin me Nr. 0321e/01R, në fshatin Kishnarekë është bërë vjedhje e votave nga anëtarët e vendvotimit, sepse është dëshmitari anëtar i këtij vendvotimi-Jakup Shala. Më tej ka theksuar se dyshon se është bërë shkelje edhe në Vendvotimin me nr. 0321e/02D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në ankesën e parashtruar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet Nr. 0321e/01R, 0321e/02D në fshatin Kishnicë, Komuna e Gllogocit, si dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet në ankesën e parashtruar, në kuptim të nenit 117 par. 3

të LZP-së, ku është përcaktuar: “se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”. Paneli gjatë vendosjes për një ankesë i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i ankesës, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon ankesën si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.582/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*